



Furçë pastrimi silikon

Përmirësoni rutinën tuaj të pastrimit me Furçën tonë Pastruese prej Silikoni, e projektuar për një pastrim të thellë por të butë. E bërë nga silikon ultra i butë dhe higjienik, ajo heq pa mundim papastërtinë dhe grimin ndërsa i jep lëkurës suaj një masazh qetësues.

Perfekte për dashamirësit e kujdesit për lëkurën e të gjitha moshave, kjo furçë praktike për fytyrën është e domosdoshme për në shtëpi, palestër ose udhëtime.

- Pastron dhe eksfolion lëkurën tuaj, dhe largon butësisht papastërtitë dhe lëkurën e vdekur.
- Ndhmon në zbutjen e lëkurës dhe nxitjen e qarkullimit të gjakut në fytyrë.
- Përgatit lëkurën për hapat tuaj të ardhshëm në rutinën tuaj të kujdesit për lëkurën.

SIZE: 6.7 x 6.7 x 4cm

MATERIALI: Silicone

Kombinojeni me HL/Skin Resurfacing Gelo Cleanser për ritualin përfundimtar të pastrimit.

Si të përdoret brusha për pastrim nga silikoni:

1. **Lagni brushën.** Para përdorimit të brushës nga silikoni, shpëlani atë me ujë të ngrohtë për t'i zbutur fijet dhe për ta pastruar.
2. **Pastroni fytyrën.** Para përdorimit të brushës nga silikoni, lagni fytyrën me ujë. Aplikoni një sasi të vogël të pastruesit në brushë, ose direkt në fytyrë. Vërejtje: Brusha nuk është e përshtatshme për zonën e syve, ndaj hiqni çdo grim/produkt nga sytë dhe shmangeni përdorimin e brushës në zonën e ndjeshme të syve.
3. **Masazhoni fytyrën.** Me lëvizje të buta rrethore, masazhoni dhe pastroni të gjithë fytyrën, duke i kushtuar më shumë kujdes zonave problematike si zona T, ku porët janë më të mëdha dhe bllokimet më të zakonshme.
4. **Shpëlani dhe thani fytyrën.** Pas rreth 1–2 minutash, shpëlani fytyrën me ujë për të larguar pastruesin dhe thani butësisht me një peshqir të pastër.
5. **Kujdesi ndaj lëkurës.** Pas pastrimit, vazhdoni me rutinën tuaj të zakonshme të kujdesit ndaj lëkurës, si tonikë, serume, kremra apo hidratues.

MIRËMBAJTJA/RUAJTJA

1. **Shpëlani mirë pas përdorimit.** Përdorni ujë të vakët për të hequr mbetjet e grimit, pastruesit/sapunit apoqelizave të vdekura që mund të kenë mbetur në brushë. Sigurohuni që ta shpëlani plotësisht brushën në çdo pjesë, përfshirë edhe hapësirat e vogla.
2. **Pastrim i thellë.** Për pastrim më të thellë, përdorni një sapun ose pastrues antibakterial të butë dhe pa aromë për të fërkuar fijet, pastaj shpëlani mirë me ujë të vakët derisa të largohet plotësisht sapuni. Mos përdorni dezinfektues të ashpër apo me përbërës të fortë.
3. **Dezinfektimi (opsional).** Edhe pse është opsional, ju rekomandojmë që brushën tuaj për pastrim nga silikoni ta dezinfektoni herë pas here. Mund të përdorni shkopinj pambuku të lagur me 70% alkool izopropilik për të fshirë butësisht fijet e brushës. Mund të përdorni gjithashtu pajisje dezinfektuese me rreze UV, të cilat përdoren për brushat e grimit apo produktet kozmetike.
4. **Tharja.** Tharja siç duhet e brushës është po aq e rëndësishme sa pastrimi, për të parandaluar zhvillimin e baktereve. Sigurohuni që të hiqni ujin e tepërt duke e shkundur brushën dhe lëreni të thahet plotësisht në ajër, në një ambient të hapur dhe të ajrosur mirë.
5. **Ruajtja.** Ruani brushën në pozicion të drejtë dhe mos e lini në dollap të mbyllur pa u tharë mirë, për të parandaluar mbledhjen e lagështirës në bazë. Ruani brushën në një vend të sigurt dhe të thatë, larg fëmijëve.

PYETJE TË SHPESHTA (FAQ)

FAQ 1: Sa shpesh duhet ta pastroj brushën time për pastrim nga silikoni?

Brushën duhet ta shpëlani pas çdo përdorimi, për të hequr mbetjet e produkteve që mund të grumbullohen në fije. Rekomandohet që brushën ta pastroni në mënyrë të thellë një ose dy herë në javë, duke përdorur sapun të butë dhe jo të ashpër.

FAQ 2: Si ta dalloj nëse brusha është e pastër?

Një brushë silikoni e pastër nuk duhet të ketë mbetje të dukshme produktesh, grumbullime apo ndonjë aromë që vjen nga produktet e pastrimit që keni përdorur. Nëse vëreni ndonjërin prej këtyre, përsëriteni procesin e pastrimit.

FAQ 3: Si mund t'i heq njollat nga brusha?

Për njollat që nuk hiqen me sapun të butë dhe ujë, provoni një pastrues grimi të butë për t'i zbutur njollat. Nëse nuk funksionon, përzieni pak sodë buke me ujë për të formuar një pastë dhe aplikojeni ngadalë mbi njollat. Lëreni për disa minuta, më pas fërkojeni me një leckë të butë ose brushë dhe shpëlajeni mirë. Kini parasysh të mos përdorni kimikate të forta për ta pastruar brushën, pasi mund ta dëmtojnë brushën apo të shkaktojnë çarje.

FAQ 4: A duhet ta thaj brushën time për pastrim nga silikoni pas përdorimit?

Po, tharja e brushës pas përdorimit është shumë e rëndësishme. Pas pastrimit të brushës, largojeni ujin e tepërt duke e shkundur brushën, thajeni me një peshqir dhe lëreni të thahet plotësisht në ajër, në një ambient të ajrosur. Mos e lini brushën në vende të mbyllura kur është ende e lagur, pasi mund të krijojë myk dhe të dëmtohet. Ruajini gjithmonë brushat nga lagështia dhe rrezet e diellit, për të ruajtur cilësinë.

FAQ 5: Çfarë produktesh mund të përdor me brushën time për pastrim nga silikoni?

Në përgjithësi, të gjithë pastruesit apo sapunët për fytyrë mund të përdoren me brushën nga silikoni. Nëse planifikoni ta përdorni për produkte me bazë vaji, testoni fillimisht në një zonë të vogël të brushës, pasi disa vajra mund ta dëmtojnë silikonin me kalimin e kohës.

FAQ 6: A mund të pastrohet brusha në pjatlarëse?

Jo, nuk rekomandohet që brusha për pastrim nga silikoni të pastrohet në pjatlarëse, pasi temperaturat e larta dhe sapunët/kimikatet e ashpra mund ta dëmtojnë dhe ta bëjnë të papërdorshme.

FAQ 7: Si ta largoj erën e plastikës?

Është normale që brushat e reja nga silikoni për pastrim të fytyrës të kenë një erë të lehtë plastike. Edhe pse kjo erë zakonisht largohet me kalimin e kohës, mund ta lani brushën disa herë me sapun të butë dhe ujë për ta larguar erën më shpejt.

FAQ 8: Kur duhet ta ndërroj brushën time për pastrim nga silikoni?

Edhe pse silikoni është material rezistent, përdorimi i vazhdueshëm e konsumon edhe brushën më cilësore. Rekomandohet ta ndërroni brushën çdo **6–12 muaj**, ose nëse dëmtohet, bëhet e papërdorshme apo nuk funksionon më siç duhet.

Emri: Pastrues fytyre

Kodi i grupit: PO/82891-1

Materiali: Silikoni

Importuar nga:

ASL Netherlands B.V. Kingsfordweg 151, 1043 GR, Amsterdam, The Netherlands

Regjistrimi i kompanisë 67368468

Nr. i TVSH-së. NL856951997B01

Prodhuar në Kinë

Prodhuar për: Herbalife International Luxembourg S.à R.L. 16, Avenue de la Gare L-1610 Luxembourg

www.herbalife.com

GPSR_support@link-worldwide.com